

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXVI, nr. 8283  
E shtunë, 18 prill 2026  
Çmimi 0.50 €

OVLUÇK-ja paralajmëron  
protesta, kërkon ligj  
për mbrojtjen e vlerave  
të luftës së UÇK-së



Na ndiqni edhe në:


[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

## HAZIRI: JEMI NË KONSULTIME ME LV-në PËR NJË MARRËVESHJE PËR PRESIDENTIN

FAQE 4-5



Deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lutfi Haziri, i cili është edhe nënkryetar i kësaj partie, ka thënë të premtën se me Lëvizjen Vetëvendosje janë

duke u konsultuar për një marrëveshje për zgjedhjen e presidentit të ri të vendit. Ai ka treguar se për këtë temë janë në konsultime aktive me LV-në.

"Kryetari i LDK-së është duke punuar për t'i dhënë një mundësi marrëveshjes mes LDK-së dhe LV-së", ka thënë Haziri

### AKTUALE



IRANI SHPALL TË HAPUR  
PËRKOHËSISHT NGUSHTICËN  
E HORMUZIT F. 2

PËRFUNDON INTERVISTIMI  
I KANDIDATËVE PËR BORDIN  
E RTK-së F. 5

PROKURORIA KËRKON BURGIM TË  
PËRJETSHËM PËR TË AKUZUARIT  
PËR VRASJEN E LIRIDONA  
ADEMAJT F. 6


### EKONOMI



GUVERNATORI I BQK-së  
TAKON ZËVENDËSDREJTORIN  
MENAXHUES TË FMN-SË,  
VLERËSOHET MBËSHËTETJA  
NGA KY INSTITUCION F. 8

SHAHINI: VONËSAT POLITIKE  
PO RREZIKOJNË PËRFITIMET E  
KOSOVËS NGA PLANI I RITJES  
SË BE-së F. 8

### SPORT



DRITON KUKA PAS PËRFUNDIMIT  
TË KAMPIONATIT EVROPIAN: NJË  
MEDALJE E ARTË DHE PARAQITJE  
PREMTUESE PËR KOSOVËN F. 11



KUVENDI E KALON NË  
PARIM PROJEKTLIGJIN  
PËR BYRONË SHËTËTORORE  
PËR KONFISKIMIN E  
PASURISË F. 5



KOSOVA DHE  
SHQIPËRIA  
SYNOJNË TË  
BASHKËPRODHOJNË  
PAJISJE USHTARAKE F. 3

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepcisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
MITROVICË  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)


**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## IRANI SHPALL TË HAPUR PËRKOHËSISHT NGUSHTICËN E HORMUZIT

TEHRAN, 17 PRILL - Ministri i Jashtëm i Iranit e ka shpallur Ngushticën e Hormuzit "plotësisht të hapur" për "periudhën e mbetur të armëpushimit". Seyed Abbas Aragchi tha se masa do të përfshijë kalimin e "të gjitha anijeve tregtare" përmes ngushticës. "Në përputhje me armëpushimin në Liban, kalimi për të gjitha anijet tregtare përmes Ngushticës së Hormuzit

shpallet plotësisht i hapur për periudhën e mbetur të armëpushimit, në rrugën e koordinuar siç është njoftuar tashmë nga Portet dhe Organizata Detare e Republikës Islamike të Iranit", ka shkruar ai.

Presidenti amerikan, Donald Trump, ka reaguar pasi ministri i Jashtëm i Iranit njoftoi se Ngushtica e Hormuzit do të jetë "plotësisht e hapur" për të gjitha anijet tregtare gjatë



periudhës së mbetur të armëpushimit. "Irani sapo ka njoftuar se ngushtica e Iranit është hapur plotësisht dhe gati për kalim të plotë. Faleminderit", ka shkruar Trump.

Deklarata e Aragchit vjen në një kohë kur Keir Starmer dhe Emmanuel Macron kanë organizuar një takim me 40 udhëheqës të tjerë.

Grupi do të diskutojë rihapjen e ngushticës.

## TRUMPI: SHBA-JA DHE IRANI MUND TË ZHVILLOJNË BISEDIME TË REJA, JEMI SHUMË AFËR NJË MARRËVESHJE

WASHINGTON, 17 PRILL - Presidenti amerikan, Donald Trump, tha se Shtetet e Bashkuara dhe Irani janë "shumë afër" që të arrijnë një marrëveshje për t'i dhënë fund luftës, duke shtuar se negociatorët e dy vendeve mund të takohen për raundin e dytë të bisedimeve gjatë kësaj fundjave. "Do të shohim se çfarë do të ndodhë. Por, mendoj se jemi shumë afër që të arrijmë një marrëveshje me Iranin", tha Trump për gazetarët në Shtëpinë e Bardhë më 16 prill, duke përsëritur fjalën "afër" më shumë se një herë dhe duke shtuar se "ka gjasa të mira që të arrijmë një marrëveshje".

Në një ngjarje që u mbajt më vonë në Las Vegas, Trump përsëriti këtë qëndrim, duke u thënë të pranishmëve se lufta po shkonte "shumë mirë" dhe



se "duhet të përfundojë shumë shpejt".

Trump dha pak detaje lidhur me elementët e mundshëm të një marrëveshjeje për përfundimin e luftës, që nisi pas sulmeve ajrore të SHBA-së dhe

Izraelit ndaj Iranit më 28 shkurt. Por, ai tha se Irani është pajtuar të "na kthejë pluhurin bërthamor", duke iu referuar rezervave të tij të uraniumit të pasuruar, i cili nëse arrin në një nivel të caktuar pasurimi është

një përbërës kyç për armët bërthamore.

Ai tha se nuk ishte i sigurt nëse armëpushimi dyjavor, që skadon më 22 prill, do të ketë nevojë të zgjatet dhe se "nëse nuk ka marrëveshje... luftimet rifillojnë", megjithëse nuk dha një afat të saktë kohor.

Udhëheqësi Trump deklaroi po ashtu se Teherani dëshiron të arrijë një marrëveshje. "Aktualisht kemi raporte të mira me Iranin, sado që është e vështirë të besohet. Dhe, mendoj se është një kombinim i katër javësh bombardime dhe një bllokade të fuqishme", tha ai, duke iu referuar bllokadës amerikane që është në fuqi që nga 13 prilli dhe që synon të parandalojë anijet që të hyjnë apo të largohen nga portet iraniane.

Raundi i parë i bisedimeve të paqes SHBA-Iran u mbajt në Islamabad më 11-12 prill dhe përfundoi pa një marrëveshje. Bisedimeve iu parapriu një armëpushim dyjavor, që u arrit më 7 prill me ndërmjetësimin e Pakistanit.

Shtëpia e Bardhë tha më 15 prill se një raund i dytë i mundshëm me gjasë do të mbahej sërish në Pakistan. Po të njëjtën ditë, një delegacion pakistanez i udhëhequr nga shefi i ushtrisë, Asim Munir, qëndroi në Teheran për të dërguar mesazhe nga Uashingtoni te Republika Islamike.

Hezbollahu konsiderohet organizatë terroriste nga Shtetet e Bashkuara, ndërsa Bashkimi Evropian ka futur në listën e zezë vetëm krahun e tij të armatosur.

## HYN NË FUQI ARMËPUSHIMI MES IZRAELIT DHE LIBANIT

JERUSALEM, 17 PRILL - Armëpushimi 10-ditor mes Libanit dhe Izraelit ka hyrë në fuqi në mesnatë, sipas kohës lokale, teksa gazetarët kanë raportuar për "të shtëna me armë zjarri" dhe lëshime raketash, që mund të kenë qenë të shtëna festuese teksa nisi armëpushimi. Media shtetërore e Libanit raportoi për vazhdim të sulmeve izraelite në jug të shtetit, por këto raportime nuk kanë mundur të verifikohen në mënyrë të pavarur. Ushtria libaneze, në orët e para të 17 prillit pretendoi për disa "shkelje të armëpushimit" nga ana e Izraelit dhe u bëri thirrje qytetarëve të mos kthehen menjëherë në fshatrat jugore. Për arritjen e armëpushimit njoftoi më 16 prill presidenti amerikan, Donald Trump, dhe më pas arritja e tij u konfirmua edhe nga udhëheqësit izraelitë dhe libanezë. Trump njoftoi për armëpushimin pasi bisedoi me kryeministrin izraelit, Benjamin Netanyahu, dhe presidentin libanez, Joseph Aoun.

Presidenti amerikan tha se planifikon t'i takojë të dy udhëheqësit brenda një ose dy jave.

Përmes një video-deklarate, Netanyahu tha se ishte pajtuar për një armëpushim 10-ditor dhe se ekziston mundësia për të arritur një marrëveshje historike me Libanin pas dekadash konflikt.

Presidenti amerikan tha se armëpushimi përfshin edhe Hezbollahun, grup militant dhe parti politike që kontrollon pjesë të mëdha të jugut të Libanit. Hezbollahu konsiderohet organizatë terroriste nga Shtetet e Bashkuara, ndërsa Bashkimi Evropian ka futur në listën e zezë vetëm krahun e tij të armatosur. Në një postim në rrjetet sociale pasi armëpushimi hyri në fuqi, Trump shkroi: "Shpresoj që Hezbollahu të silltet mirë gjatë kësaj periudhe të rëndësishme. Do të ishte një moment i madh për ta nëse e bëjnë këtë. Jo më vrasje. Duhet më në fund të ketë

paqe!".

Libani ka këmbëngulur që të arrihet një armëpushim para se të zhvillojë bisedime të mëtejme, por ka premtuar se do të çarmatosë militantët e Hezbollahut.

Disa pamje të publikuara nga AFPTV shfaqën njerëz duke u kthyer në bastionin e Hezbollahut dhe disa prej tyre valëvitnin flamurin e verdhë të grupit, që mbështetet nga Irani, dhe disa duke mbajtur fotografinë e udhëheqësit të vrarë të Hezbollahut, Hassan Nasrallah, i cili u vra nga Izraeli në vitin 2024. Paraprakisht, Hezbollahu u kishte bërë thirrje banorëve që të mos kthehen në zonën në jug të Libanit, para se të jetë e qartë se armëpushimi po respektohet. Ky grup po ashtu u ka kërkuar njerëzve që të mos festojnë me armë.

Izraeli ka kryer sulme ndaj militantëve të Hezbollahut, të mbështetur nga Irani, në Libanin



fqinj që nga 2 marsi, dy ditë pas fillimit të luftës SHBA-Izrael kundër Iranit, kurforcat e Hezbollahut hapën zjarr në mbështetje të Teheranit. Armëpushimi dyjavor për luftën në Iran nuk vlente edhe për Libanin.

Ushtria izraelite tha se forcat e saj do të mbeten të dislokuara në jug të Libanit edhe pas armëpushimit dhe u bëri thirrje banorëve libanezë që të mos lëvizin në jug të lumit Litani, që gjendet rreth 20-30 kilometra në veri të kufirit me

Izraelin.

Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, Antonio Guterres, e përhëndeti njoftimin për armëpushim dhe u bëri thirrje "të gjithë aktorëve" që ta respektojnë plotësisht armëpushimin, tha zëdhënësi i tij. "Sekretari i Përgjithshëm e mirëpret njoftimin për një armëpushim 10-ditor mes Izraelit dhe Libanit dhe vlerëson rolin e Shteteve të Bashkuara në ndërmjetësimin e tij", tha përmes një deklarate zëdhënësi i Guterresit, Stephane Dujarric.

# KOSOVA DHE SHQIPËRIA SYNOJNË TË BASHKËPRODHOJNË PAJISJE USHTARAKE

PRISHTINË, 17 PRILL - Kosova dhe Shqipëria po diskutojnë që të thellojnë bashkëpunimin në fushën e industrisë së mbrojtjes, përfshirë bashkëprodhimin dhe blerjet e përbashkëta, thanë ministrat e Mbrojtjes të të dyja vendeve.

Pas takimit në Prishtinë të ministrit të Mbrojtjes të Shqipërisë, Ermal Nufi, me homologun kosovar, Ejup Maqedonci, udhëheqësit e fushës së mbrojtjes e vlerësuan me rëndësi të madhe bashkëpunimin në industrinë e mbrojtjes.

Maqedonci u pyet të specifikonte se çfarë nënkupton ky bashkëpunim. Ai tha se dy shtetet veçse kanë bërë hapa në zhvillimin e industrisë së mbrojtjes. “Ne kemi bërë një kontratë për një fabrikë për prodhimin e municioneve”, tha ai, duke i referuar marrëveshjes së arritur në dhjetor të vitit 2024 me prodhuesin shtetëror turk, MKE.

Qeveria e Kosovës ka thënë më herët se fabrika do të ndërtohet në Jahoc të Gjakovës, ndërsa prodhimi i parë pritet të dalë në fund të vitit 2026.

Maqedonci tha se Kosova është në koordinim edhe me partnerët e tjerë për çështjen e bashkëprodhimit. “Po flasim për bashkëpunimin me Shqipërinë në fushën e industrisë, po flasim në dy drejtime. Është bashkëprodhimi, pra po shikojmë mundësitë se në cilat fusha mund të bashkëprodhojmë dhe kjo do të bëhet në periudhën në vazhdim kur të formojmë grupet dhe ekipet për identifikimin se çfarë mund të bashkëprodhojmë. Por, edhe në bashkëprodhim të sistemeve që na bëjnë të ndërveprueshëm. E kemi edhe



në deklaratën me Shqipërinë dhe Kroacinë si ndër pikat kyç bashkëprodhimin, por edhe prokurimet e përbashkëta si tri vende që të na mundësojë të jemi të ndërveprueshëm dhe pajisje cilësore”, tha Maqedonci. Në anën tjetër, ministri Nufi tha se diskutimet për bashkëpunimin në industrinë e mbrojtjes janë thelbësore.

“Bashkëpunimi në këtë fushë është thelbësor për kapacitetet tona dhe garantimin e sigurisë të të dyja vendeve. Besoj se ky diskutim do të vijojë edhe më tej me të gjitha impiantet e prodhimit që po ngrihen në

Kosovë dhe Shqipëri, si simbol jo vetëm të zhvillimit teknologjik dhe industrial, por edhe bashkëpunimit vëllazëror”, tha ai.

Teksa Kosova po synon të prodhojë municione, Shqipëria, në fillim të prillit, vendosi bëri hapat e parë drejt prodhimit të dronëve luftarakë, si dhe për ndërtimin e riparimit e mjeteve motorike lundruese ushtarake dhe civile, duke autorizuar arritjen e marrëveshjeve me kompani të mbrojtjes.

Bashkëpunimi në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes mes Kosovës dhe Shqipërisë,

parashihet edhe në deklaratën që Prishtina, Tirana dhe Zagrebi nënshkruan vitin e kaluar.

Serbia e ka parë këtë bashkëpunim si aleancë ushtarake kundër saj dhe serbëve, por ky pretendim vazhdimisht është mohuar nga Kosova, Shqipëria dhe Kroacia. Nufi po ashtu u pyet nëse ka ngritur shqetësime në NATO për armatosjen e Serbisë me armë kineze. Por, ai tha se sa i përket kësaj çështjeje, “Republika e Serbisë i vendos vet çështjen e armatimit apo si i konsideron çështjet e sigurisë së saj, si i ka doktrinën ushtarake në raport

me sigurinë”.

Dy ditë, presidenti serb, Aleksandar Vuçiq, tha se Serbia do të blejë armatime të reja pasi gjoja po përballet me trysni nga shtetet fqinje. “Gjendja e sigurisë është disi më ndërlikuar sesa në janar, kur e trajtuam atë, kryesisht për shkak të veprimeve dhe aktiviteteve të mëtejshme të aleancës ushtarake të Prishtinës, Tiranës dhe Zagrebit”, tha Vuçiq të mërkurën.

Kjo nuk është hera e parë që Vuçiq e ka bërë këtë pretendim, por ai asnjëherë nuk ka dhënë dëshmi për ta mbështetur atë.

## OVLUÇK-ja PARALAJMËRON PROTESTA, KËRKON LIGJ PËR MBROJTJEN E VLERAVE TË LUFTËS SË UÇK-së

PRISHTINË, 17 PRILL - Nën kryetari i OVLUÇK-së, Gazmend Syla, ka mbajtur një konferencë për medie të premten, në të cilën ka njoftuar se ia kanë adresuar tri kërkesa kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti dhe u.d. presidentes, Albulena Haxhiu, për të cilat, sipas tij, ende nuk ka marrë përgjigje.

Syla ka sqaruar kërkesat e dërguara dhe mungesën e përgjigjes nga institucionet. “Më 20 shkurt i kemi dërguar një kërkesë z. Albin Kurti edhe znj. Albulena Haxhiu. Në fakt është një kërkesë që ka tri kërkesa të tjera brenda saj. Bëhet fjalë për një të është

më e rëndësishmja për ne: Hartimi dhe miratimi i Ligjit për Mbrojtjen e Vlerave të Luftës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Prej kësaj date, pra 20 shkurt të 2026-s, nuk kemi marrë asnjë përgjigje lidhur me këtë kërkesë, qoftë eventualisht edhe për një takim të mundshëm me krerët e këtyre dy institucioneve. Prandaj, ju bëjmë me dije se kemi diskutuar me të gjitha strukturat tona dhe kërkojmë nga Qeveria e Republikës së Kosovës, nga Parlamenti i Republikës së Kosovës, që urgjentisht të marrin hapat e parë drejt fillimit të hartimit të këtij ligji dhe miratimit të tij”,



është shprehur Syla.

Ai shtoi se nëse nuk ka reflektim nga institucionet, do

të detyrohen të dalin në protesta. “Ju e dini që prej pasluftës, ne si organizatë e

veteranëve të luftës, por edhe shoqatat e tjera, i kemi adresuar këto probleme që kemi me këta njerëz të cilët ofendojnë luftën tonë çlirimtare prej pasluftës, por kjo logjikë e të menduarit të këtyre njerëzve veçse është rritur, dhe po vazhdon të rritet kohëve të fundit. Prandaj, pas konsultave me strukturat tona kemi marrë vendim që në qoftë se qeveria dhe parlamenti nuk marrin iniciativë për hartimin e këtij ligji, neve nuk na mbetet gjë tjetër vetëm të dalim në rrugë dhe të protestojmë për këto të drejta që na takojnë”, ka thënë Syla.



# KUVENDI E KALON NË PARIM PROJEKTLIGJIN PËR BYRONË SHETËRORE PËR KONFISKIMIN E PASURISË

PRISHTINË, 17 PRILL - Ligjvënësit e kanë kaluar në lexim të parë një projektligj për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme, me gjithë vërejtjet e partive kryesore opozitare për përmirësimin e tij dhe hedhjen e tij në diskutim publik.

Me 81 vota për, asnjë kundër dhe 25 abstenime, projektligji kaloi pengesën e parë pas një debati të gjatë në një seancë të premtën.

Ky projektligj - i cili ka qenë prej kohësh prioritet i kryeministrit Albin Kurti - duhet të kalojë edhe në lexim të dytë për t'u bërë ligj. Synimi i këtij ligji është ta verifikojë ligjshmërinë e pasurisë të të gjithë zyrtarëve publikë në Kosovë, dhe pastaj t'ia lërë në dorë gjyqësorit konfiskimin e saj nëse vërtetohet se ajo ishte fituar kundërligjshëm.

Në paraqitjen e projektligjit, ministrja e Drejtësisë, Donika Gërvalla, tha se ai e thotë qartë se "funksioni publik nuk mund të jetë mburojë për pasurim të pajustificueshëm". "Është një projektligj që e bën të qartë se në Kosovë, atëherë kur ushtron funksion publik askush nuk mund të jetë mbi detyrimin për ta justifikuar, arsyetuar pasurinë e vet. Ky projektligj është mesazh i qartë dhe shumë i prituri nga qytetarët se shteti nuk

mjaftohet me deklarime kundër korrupsionit, por ndërton mekanizma realë, funksionalë për ta luftuar atë", tha ajo.

Gërvalla kujtoi se hapat e parë për këtë ligj u ndërmorën më 2021 dhe projektligji ka kaluar në tri opinione të Komisionit të Venedikut dhe dy shqyrtimeve nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës. "As Komisioni i Venedikut, as Kushtetuesja nuk kanë kundërshtuar konceptin e konfiskimit civil si instrument juridik", tha Gërvalla, duke shtuar se rekomandimet janë përfshirë në projektligj. "Procedurat nuk nisi arbitrarisht", theksoi Gërvalla. "Ato iniciohen në bazë të informacioneve kredibile".

Sipas saj, Byroja nuk konfiskon, gjykon apo zëvendëson gjykatat. "Byroja mbledh, verifikon dhe analizon informacionin. Vendimi për konfiskim merret nga gjykata. Pra, një mekanizëm kushtetues, i balancuar dhe në harmoni me parimet e shtetit ligjor", tha ajo.

Po ashtu, Gërvalla i cilësoi si "propagandë" informacionet se projektligji synon qytetarët e zakonshëm, duke theksuar se cak janë zyrtarët publikë që kanë pasuri të pajustificuar.

Deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës në opozitë, Përparim Gruda, tha se në parim, partia e tij nuk është kundër projektligjit.

"Në parim nuk jemi kundër ligjit as kundër konceptit civil të pasurisë. Për dallim nga ai penal që kërkon që barra e provës të vendoset te standardi përtej dyshimit të arsyeshëm, konfiskimi civil e ka një standard më të ulët që është vlerësimi i gjasave", tha Gruda.

Gruda tha se PDK-ja ka disa vërejtje sa i përket projektligjit, sikurse është se për të nuk ka pasur konsultim publik.

Ai po ashtu tha se duhet që projektligji të jetë më i qartë, duke përmendur këtu çështjen e kompensimit, për personat që u bllokohet pasuria, por në fund del se nuk kanë bërë shkelje ligjore. Në ligj, sipas tij, ka formulim të përgjithshëm për kompensimin, ku thuhet se do të bëhet sipas legjislacionit civil. "Mënyra e shkrimit të tekstit nuk është gjuhë juridike, është publicistikë", tha ai, duke lexuar disa nene të tij.

PDK-ja, tha deputeti Gruda, do të abstenojë në lexim të parë dhe do ta përkrahë ligjin vetëm nëse vërejtjet e saj adresohen. "Nëse ne, mes dy leximeve, japim shans që Kuvendi të organizojë konsultim publik legjislativ, ne mund t'i adresojmë të gjitha vërejtjet e Gjykatës Kushtetuese dhe ta kalojmë bashkë këtë ligj. PDK sot do të abstenojë që të japë një shans që mes dy leximeve të përmirësohet", tha

Gruda.

Edhe Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) kërkoi që projektligji duhet të hidhet së pari në konsultim publik dhe argumentoi se ai ka paqartësi. Deputetja e LDK-së, Doarsa Kica-Xhelili, tha se projektligji si i tillë, nëse bëhet ligj, atëherë mund t'i prekë shumë familje të cilat kanë ndërtuar pasuri falë ndihmës së familjarëve të tyre në mërgim përmes remitancave. "Ministrja tha se qytetari i rëndomtë nuk do të preket, por ne po harrojmë se 80.000 zyrtarë publikë janë familjarë të qytetarëve të rëndomtë. Një familje në Kosovë, që mund ta ketë një zyrtar publik, mund të ketë pranuar për 18 vjet edhe të holla nga mërgata; para të sjella kesh e pa kontrata. Sipas këtij ligji, kjo familje mund të thirret për ta dëshmuar çdo cent, e çka ndodh me atë familje nëse nuk mund ta dëshmojë këtë?"

Ajo argumentoi se ka paqartësi brenda neve, kundërthënie brenda ligjit dhe shtoi se kur vetë ligji nuk është i qartë "ai nuk është neutral, ai bëhet i rrezikshëm, sepse sot mund të interpretohet në një mënyrë, e nesër në një mënyrë tjetër". Kica-Xhelili gjithashtu nënvizoi se Byrosë i mungon pavarësi, duke qenë se, sipas projektligjit, komisioni i saj zgjedh drejtorin e saj, bën vlerësimin e tij dhe ka

fuqinë ta shkarkojë atë.

Komisioni i Byrosë zgjidhet nga Kuvendi i Kosovës me një shumicë të thjeshtë prej 61 deputetësh, sipas projektligjit.

Në fund të marsit, Qeveria e Kosovës e miratoi projektligjin dhe e procedoi në Kuvend për miratim në dy lexime.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, më herët e ka cilësuar këtë projektligj si një nga prioritetet e ekzekutivit.

Gjykata Kushtetuese e Kosovës ia kishte rrëzuar Qeverisë Kurti dy herë Ligjin për verifikimin dhe konfiskimin e pasurisë së pajustificueshme, së pari më 2024 dhe pastaj në fillim të këtij viti.

Ky ligj synon që të gjithë zyrtarët publikë në Kosovë të jenë subjekt i verifikimit të pasurisë nëse ka kishte dyshime se ajo është fituar në mënyrë të kundërligjshme.

Gjykata më e lartë në Kosovë në vendimin e janarit se e shfuqizoi ligjin për byronë sepse ai u miratua me "shkelje të rënda procedurale dhe kushtetuese".

Sipas saj, Kuvendi e përdori në mënyrë të pajustificuar shmangien nga afatet procedurale, duke mos u dhënë deputetëve dhe komisioneve kohë për shqyrtim, debat dhe amendamente, në kundërshtim me nenet 74, 76 dhe 77 të Kushtetutës.

# HAZIRI: JEMI NË KONSULTIME ME LV-në PËR NJË MARRËVESHJE PËR PRESIDENTIN

Deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lutfi Haziri, i cili është edhe nënkryetar i kësaj partie, ka thënë të premtën se me Lëvizjen Vetëvendosje janë duke u konsultuar për një marrëveshje për zgjedhjen e presidentit të ri të vendit. Ai ka treguar se për këtë temë janë në konsultime aktive me LV-në. “Kryetari i LDK-së është duke punuar për t’i dhënë një mundësi marrëveshjes mes LDK-së dhe LV-së”, ka thënë Haziri

EPOKA  
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 17 PRILL - Deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës në opozitë, Lutfi Haziri, tha të premtën se me Lëvizjen Vetëvendosje janë duke u konsultuar për një marrëveshje për zgjedhjen e presidentit të ri të vendit. Sipas tij, qëllimi është që sa më shpejt të sigurohet funksionaliteti institucional, teksa Kosova aktualisht ka ushtruese të detyrës së presidentit, pasi ish-presidentes Vjosa Osmani i skadoi mandati pesëvjeçar më 4 prill. Këtë post, sipas Kushtetutës, e mori kryeparlamentarja Albulena Haxhiu.

Haziri tha se konsultimet janë “aktive” dhe se kreu i partisë, Lumir Abdixhiku po punon që t’i jepet “një mundësi marrëveshjes mes LDK-së dhe LV-së”. “Jemi në konsultime aktive, kryetari i LDK-së është duke punuar për t’i dhënë një mundësi marrëveshjes mes LDK-së dhe LV-së. Qëllim ynë është që shteti të jetë funksional dhe të kemi organin më të lartë përfaqësues sa më shpejt. Jemi në 11 ditët e fundit dhe ky afat duhet të na obligojë që sa më shpejt t’i japim vendit një marrëveshje”, ka deklaruar Haziri.


Një ditë më parë, kryeministri i Kosovës, njëherësh udhëheqësi i LV-së në pushtet,

Albin Kurti, po ashtu tha për mediat se është në komunikim me LDK-në dhe se “kur te kemi rezultate do të ju njoftojmë”. Deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë afat deri më 28 prill që të zgjedhin presidentin, në të kundërtën vendi shkon në zgjedhje.

Kurti, ditë më parë ka zhvilluar takim me Lumir Abdixhikun, kryetarin e LDK-së, por takimi ka përfunduar pa ndonjë marrëveshje për presidentin. LDK-ja në legjislaturën e dhjetë ka 15 deputetë.

LV-ja më herët ka paralajmëruar edhe takime të tjera me LDK-në dhe PDK-në. Ish-deputeti Burim Ramadani ka thënë se edhe nëse Kosova shkon në zgjedhje në qershor apo korrik 2026, sërish do të duhet të ketë negociata dhe konsensus për presidentin e ri. “Nuk ka gjasa që kjo çështje të zgjidhet vetvetiu. Partitë sërish do të duhej të gjejnë një kandidat sa më konsensual”, ka thënë ai.

Zëvendëskryeministri i parë, njëherësh ministri i Jashtëm, Glauk Konjufca, tha se çështja e zgjedhjes së presidentit të ri të vendit varet nga vullneti i partive opozitare. “Shkojmë në zgjedhje të reja nëse ky është vullneti i opozitës, nuk kemi çfarë të bëjmë”, tha ai për mediat të mërkurën. Ndërkaq, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, tha shkurt për mediat se është në kontakt me krerët e partive opozitare, dhe “kur ka



rezultate atëherë ju njoftojmë”. Nënkryetarja e Kuvendit nga radhët e PDK-së, Vlora Çitaku, ka folur një ditë më parë pas mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit, duke komentuar çështjen e zgjedhjes së presidentit.

Ajo theksoi se përgjegjësia kryesore bie mbi shumicën parlamentare, duke shtuar se ajo ka alternativa dhe nuk është e detyruar të negociojë vetëm me PDK-në.

“Parlamenti i Kosovës i ka 120 deputetë, PDK-ja i ka vetëm 22 deputetë. Shumica parlamentare, nëse është e interesuar për ta zgjedhur presidentin, nuk e ka opsion të vetëm bisedimin dhe dakordimin me PDK-në, ka edhe opsione tjera”, tha Çitaku.

Ajo e cilësoi zgjedhjen e presidentit si një moment të rëndësishëm për demokracinë parlamentare, duke kërkuar qasje më serioze nga Qeveria. “Zgjedhja e presidentit është

moment i rëndësishëm për një demokraci parlamentare dhe kjo duhet të trajtohet me seriozitetin që i takon”, u shpreh ajo.

Çitaku bëri të ditur se PDK ka kërkuar nga kryeministri Albin Kurti që të formalizojë kërkesat ndaj këtij subjekti politik. “Kemi kërkuar nga z. Kurti që ta formalizojë kërkesën e tij karshi PDK-së me një letër të shkruar. Deri në këtë moment, një letër e tillë nuk ka ardhur në adresë të PDK-së”, tha Çitaku.

LV-ja e Kurtit më 5 mars propozoi dy emra për pozitën e presidentit: Glauk Konjufcën, ministrin e Punëve të Jashtme dhe Diasporës dhe deputeten Fatmire Mullhaxha -Kollçaku. Në mungesë kuorumi, procesi ka mbetur në gjysmë.

Konjufca tha më 16 prill se tërheq kandidaturën nëse opozita del me një kandidaturë të përbashkët.

Më 6 mars, një ditë pas seancës për presidentin, ish-

presidentja Vjosa Osmani prezantoi një dekret për shpërndarje të Kuvendit dhe hapje të rrugës për zgjedhje të reja. Vetë Osmani e synonte edhe një mandat të dytë, mirëpo nuk e siguroi mbështetjen e nevojshme në këtë drejtim.

Dekreti u dërgua në Gjykatën Kushtetuese nga Qeveria.

Gjykata më pas doli me vendim duke thënë se dekreti i ish-presidentes nuk ka pasur asnjë efekt juridik dhe e përcaktoi 28 prillin si afat të fundit për zgjedhje të presidentit, në të kundërtën shteti shkon në zgjedhje që duhen të mbahen brenda 45 ditësh.

LV-ja i ka fituar bindshëm zgjedhjet e parakohshme të 28 dhjetorit të vitit 2025 dhe gëzon 57 ulëse në Kuvend, por ato janë të pamjaftueshme për zgjedhjen e presidentit, meqë për të finalizuar këtë proces nevojiten të paktën 80 vota në Kuvendin me 120 deputetë.

## PËRFUNDON INTERVISTIMI I KANDIDATËVE PËR BORDIN E RTK-së

PRISHTINË, 17 PRILL - Komisioni Ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Bordit të RTK-së ka përmbyllur procesin e intervistimit të kandidatëve. Kuvendi i Kosovës ka njoftuar se i gjithë procesi ka qenë i hapur, transparent dhe është monitoruar nga shoqëria civile dhe i njëjti është zhvilluar brenda afate të përcaktuara ligjore.

Për gjashtë pozita për anëtarë të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës, komisioni ka propozuar për votim se seancë plenare dymbëdhjetë kandidatë: Valmirë Thaqi, Flokart Aliu, Gëzim Brahaj, Fatos Mustafa, Arbërore Riza, Xheraldina

Cërnobregu, Njomza Beqiri Novosella, Anita Toqi, Lulzim Beqiri, Fatmir Podrimaj, Ilirjan Himaj dhe Avni Zuka.

Prej dymbëdhjetë kandidatëve të propozuar Kuvendi zgjedh gjashtë anëtarë të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës.

Për një pozitë për anëtar të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës, nga radhët e komunitetit serb, komisioni ka propozuar për votim dy kandidatë: Ivana Milić dhe Vidosav Kostović, ndërsa për një pozitë për anëtar të Bordit nga radhët e komuniteteve të tjera jo shumicë, janë propozuar kandidatët Anesa Čolaković dhe Aldin Šabani.



# HARADINAJ KËRKON CEREMONI PËRKUJTIMORE PËR ELIOT ENGELIT DHE VENDOSJEN E MEMORIALIT TË PËRHERSHËM BRENDA HAPËSIRAVE TË INSTITUCIONIT


PRISHTINË, 17 PRILL - Kryetari i Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, Ramush Haradinaj, ka dorëzuar zyrtarisht në Kuvendin e Kosovës kërkesën për organizimin e një ceremonie përkujtimore në nder të mikut të madh të shqiptarëve, Eliot Engel, i cili vdiq më 10 prill në moshën 79-vjeçare.

Haradinaj ka theksuar se

përmes kësaj nisme synohet shprehja e mirënjohjes institucionale për rolin e Engelit në mbështetje të lirisë, pavarësisë dhe shtetndërtimit të Kosovës, duke e cilësuar atë si një ndër zërat më të fuqishëm në momentet kyçe për vendin. Sipas propozimit, kërkohet mbajtja e një seance të veçantë përkujtimore në Kuvend, krijimi i një çmimi vjetor "Eliot Engel",

si dhe vendosja e një memoriali të përhershëm brenda hapësirave të institucionit.

Kreu i AAK-së ka vlerësuar se nderimi i miqve të Kosovës është detyrim institucional dhe kombëtar, duke shtuar se kjo iniciativë synon të ruajë kujtesën historike dhe të forcojë aleancën e përhershme me Shtetet e Bashkuara të Amerikës.



## PROKURORIA KËRKON BURGIM TË PËRJETSHËM PËR TË AKUZUARIT PËR VRASJEN E LIRIDONA ADEMAJT

Kryetarja e trupit gjykues në rastin e vrasjes së Liridona Ademajt, Fatime Dermaku, ka njoftuar se vendimi për këtë çështje penale do të shpallet më 21 prill në orën 13:30. Ndërkaq të premtën Prokuroria Themelore në Prishtinë ka kërkuar burgim të përjetshëm për Naim Murselin dhe të akuzuarit e tjerë në rastin për vrasjen e Liridona Ademajt

PRISHTINË, 17 PRILL - Në fjalën përfundimtare, Prokuroria Themelore në Prishtinë ka kërkuar burgim të përjetshëm për Naim Murselin dhe të akuzuarit e tjerë në rastin për vrasjen e Liridona Ademajt.

Prokurorja Javoroka Perlinqeviq gjatë fjalës së saj, tha se Murseli, bashkëshorti i Ademajt, ka vepruar për përfitim financiar dhe moral, duke e simuluar një grabitje në të cilën viktimja është trajtuar si "dëm kolateral", teksa sipas aktakuzës, ai ka marrë pjesë në organizimin dhe planifikimin e vrasjes.

Kryetarja e trupit gjykues në rastin e vrasjes së Liridona Ademajt, Fatime Dermaku, ka njoftuar për përfundimin e shqyrtimit gjyqësor dhe datën e shpalljes së aktgjykimit. Ajo bëri me dije se vendimi për këtë çështje penale do të shpallet më 21 prill në orën 13:30.

Liridona Ademaj u vra në nëntor të vitit 2023. Murseli akuzohet për planifikimin e vrasjes. Granit Plava akuzohet se e ka kryer vrasjen, ndërkaq Kushtrim Kokalla akuzohet se e ka njoftuar dorasin e dyshuar me Murselin. Perlinqeviq i ka propozuar Gjykatës Themelore në Prishtinë që të shpallë fajtorë të akuzuarit dhe të dënohen me burgim të përjetshëm, duke argumentuar se veprimi, mënyra e kryerjes, sjellja pas ngjarjes dhe tentativat për manipulim publik rëndojnë pozitën e tyre, ndërsa sipas saj nuk ekzistojnë rrethana lehtësuese, raporton Betimi për Drejtësi.

Prokurorja theksoi se gjatë shqyrtimit gjyqësor janë paraqitur tri versione të ndryshme të ngjarjes nga të akuzuarit, të cilat, sipas saj, paraqesin përpjekje për shmangie të përgjegjësisë penale dhe bartje të fajit te të tjerët, duke e quajtur këtë "tre skenarë të ndryshëm të një ngjarjeje".

Ajo shtoi se, sipas provave të administruara, i akuzuari Naim Murseli ka kaluar pasditen e ditës kritike me të akuzuarin



Granit Plava, me të cilin dyshohet se ka blerë armën e përdorur në kryerjen e veprës, si dhe ka përdorur veturë të huazuar në atë periudhë. Sipas saj, këto rrethana nuk përputhen me deklaratimet e mbrojtjes dhe analizat e video-incizimeve tregojnë lëvizje të koordinuara të automjeteve.

Prokurorja Perlinqeviq tha se gjatë gjykimit janë paraqitur prova materiale, janë marrë në pyetje të gjithë dëshmitarët që kishin njohuri për rrethanat e rastit, por janë paraqitur edhe prova nga mbrojtja.

Ajo e cilësoi si "makabër" vrasjen e Ademajt para dy fëmijëve të saj, që atëbotë ishin katër dhe gjashtë vjeç.

Sipas saj, djali i madh, në prani të psikologut, ka deklaruar: "hajni e futi dorën dhe ia bëri mamit bam". Gjithashtu, ajo përmendi dëshminë e vëllait të viktimit, sipas së cilës fëmijët e

kanë sqaruar qartë ngjarjen dhe nuk dëshirojnë të komunikojnë me babanë e tyre, të akuzuarin Murseli, duke refuzuar edhe thirrjet telefonike të mundësuar përmes Qendrës për Punë Sociale në Suedi.

Prokurorja e rastit përmendi po ashtu se qershorin e vitit 2022, familja Murseli në Suedi kishte paguar një policë sigurimi në emër të viktimit Liridona Ademaj, dhe se sipas saj, pas kësaj, i akuzuari Naim Murseli i kishte kërkuar të akuzuarit Kushtrim Kokalla të gjejë mënyrën për vrasjen e saj.

I akuzuari për vrasjen e gruas së tij, Naim Murseli, ka mohuar përfshirjen në këtë rast, duke deklaruar se nuk ka organizuar dhe as nuk ka marrë pjesë në vrasjen e Liridona Ademajt. Gjatë fjalës së tij përfundimtare në gjykatë, ai tha se në momentin e vrasjes nuk ka qenë në vendin e ngjarjes dhe se

bashkë me fëmijët ishte duke u larguar.

Vëllai i Liridona Ademajt, Leonardi, ka kërkuar dënim me burgim të përjetshëm për tre të akuzuarit për vrasjen e saj, duke theksuar se gjatë procesit gjyqësor është dëshmuar se krimi është organizuar nga Naim Murseli në bashkëpunim me Kushtrim Kokallën dhe me ekzekutim nga Granit Plava. Në fjalën përfundimtare, ai ka deklaruar se provat dhe dëshmitë e paraqitura gjatë gjykimit e bëjnë të qartë organizimin e vrasjes.

### Si ndodhi vrasja?

Liridona Ademaj u vra në moshën 30-vjeçare më 29 nëntor 2023 në një rrugë në fshatin Bërnice të Prishtinës. Aktakuza e ngarkon Murselin se e ka planifikuar vrasjen e bashkëshortes me qëllim

hakmarrjeje dhe përfitimi financiar nga një sigurim jetësor në Suedi, në shumë prej rreth 260 mijë eurosh.

Sipas Prokurorisë, Murseli e ka planifikuar vrasjen në bashkëpunim me Kushtrim Kokallën dhe Granit Plavën, duke u premtuar atyre një shpërblim prej 30 mijë eurosh për ta kryer krimin.

Vrasja e Liridona Ademajt shkaktoi zemërim publik, veçanërisht pasi bashkëshorti i saj mori pjesë në varrim.

Familja kërko zhvarrosjen e trupit të saj për ta varrosur në varrezat e familjes Ademaj.

Që nga viti 2010, në Kosovë u vranë rreth 60 gra - shumica nga bashkëshortët e tyre.

Organizatave të drejtave të njeriut kritikojnë sistemin e drejtësisë për dënime të lehta të autorëve - gjë që, sipas tyre, i trimëron dorasit.

# NDEROHEN TË RËNËT E MASAKRËS SË POKLEKUT E TË ÇIKATOVËS: DËSHMI TË QARTA TË GJENOCIDIT TË SERBISË NË KOSOVË

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 17 PRILL - Ushtruesja e detyrës së presidentit dhe kryetarja e Kuvendit të Kosovës, Albulena Haxhiu, ka nderuar të rënë në masakrën e Poklekut e të Çikatovës, të kryer nga Serbia 27 vite më parë.

Duke i konsideruar dëshmi të gjenocidit të Serbisë në Kosovë, kryetarja Haxhiu tha se në këto dy fshatra forcat policore dhe ushtarake serbe kryen një nga krimet më të rënda dhe më çnjerëzore në Kosovë, duke vrarë 77 civilë shqiptarë të paarmatosur.

Në Poklek u vranë 53 civilë të pafajshëm, prej të cilëve 23 fëmijë nga 6 muajsh deri në 14 vjeç, ndërsa në Çikatovë të Vjetër u vranë 24 civilë të tjerë. Në Poklek, familjet Muqolli, Elshani, Çaraku dhe Hoxha, pasi u detyruan me forcë të kthehen

brenda një shtëpie, u ekzekutuan brutalisht me bomba dore dhe automatikë, ndërsa trupat e tyre u dogjën për disa herë me radhë.

Djegia e përsëritur e trupave, shtoi kryetarja Haxhiu, nuk kishte vetëm qëllim fshehjen e krimit, por dëshmonte qartë synimin për shfarosje të plotë. Kryetarja e Kuvendit kujtoi që në Çikatovën e Vjetër, civilët e vrarë u transportuan dhe trupat e tyre u zhdukën në mënyrë të organizuar, duke u groposur në varreza masive në Rudnicë të Rashkës, në Serbi. Kjo, shtoi kryetarja e Kuvendit, ishte një përpjekje e qëllimshme për zhdukjen e gjurmëve të krimit dhe fshehjen e së vërtetës. “Këto ngjarje përbëjnë dëshmi të qarta të gjenocidit ndaj popullsisë civile shqiptare në Kosovë. Autorët e këtyre krimeve edhe pse dihen nuk janë përballur kurrë me drejtësinë. Madje disa

prej tyre janë shpërblyer në Serbi”, nënvizoi kryetarja Haxhiu.

Kryetarja e Kuvendit theksoi se Republika e Kosovës tashmë ka bazën ligjore që mundëson ndjekjen dhe gjykimin në mungesë të kriminelëve të luftës dhe me vendosmëri kërkohet që përgjegjësit e këtyre krimeve të ndiqen, të gjykoen dhe të dënohen, qoftë edhe në mungesë. “Ne nuk harrojmë. Këto krime nuk mund të fshihen dhe nuk mund të relativizohen. Ato mbeten një plagë e hapur e historisë sonë dhe një thirrje e përhershme për drejtësi”, tha kryetarja Haxhiu.

Po sot kryetarja Albulena Haxhiu bëri homazhe edhe në fshatin Krajkovë, në kujtim dhe nderim të ushtarit të UÇK-së, dëshmorit Sokol Elshani, i rënë heroikisht 27 vite më parë. “Kosova ka qenë me fat që ka pasur të tillë luftëtarë, e të tillë çlirimtarë, si

ai”, tha kryetarja Haxhiu.

Edhe kryeministri Albin Kurti ka përkujtuar këto dy masakra, duke theksuar se: “Në Poklek të Drenicës, në shtëpinë e familjes Muqolli, më 17 prill 1999, u vranë 53 civilë shqiptarë të paarmatosur, nga 75 vjeç deri te foshnje 6-muajshe, përfshirë edhe gra shtatzëna”. “U vranë dhe më pas trupat e tyre u dogjën nga forcat e armatosura të Serbisë, në përpjekje për të fshehur gjurmët e krimit. Sot, kujtimi për ta ruhet në shtëpinë-muze të familjes Muqolli në Poklek, e mbështetur institucionalisht nga Republika e Kosovës. Aty ruhen dëshmi dhe histori familjare që e bëjnë të prekshme përmasën njerëzore të humbjes dhe obligimin tonë për të mos harruar. Në Korroticë të Poshtme ruhen kujtimet për poetin e fëmijëve Ymer Elshani, i vrarë atë ditë bashkë me më të

dashurit e tij”, ka thënë ai, duke shtuar se në Çikatovë të Vjetër të Drenicës, civilë të tjerë shqiptarë u vranë dhe trupat e disa prej tyre u zhvendosën në varrezën masive në Rudnicë të Rashkës në Serbi. “Përkujtimi i tyre është obligim institucional dhe shoqëror. Dokumentimi i krimeve dhe ruajtja e dëshmive janë thelbësore për të vërtetën historike dhe për drejtësinë. Krimet e luftës nuk parashkruhen, dhe drejtësia për viktimat mbetet kërkesë e pandërprerë. Me respekt të thellë për të vrarët dhe me solidaritet me familjarët e tyre, riafirmojmë përkushtimin tonë për të vërtetën, kujtesën dhe drejtësinë”, ka shkruar Kurti në “Facebook”.

Nënkryetarja e Kuvendit të Kosovës nga radhët e PDK-së, Vlora Çitaku, duke kujtuar këto dy masakra, ka theksuar se në sytë me lot dhe dhembjen që ende rëndon shpirtin e familjarëve të martirëve të Kosovës, edhe pas 27 vitesh qëndron e vërteta e luftës sonë për liri. “E vërteta që flet më qartë se kurrë për viktimat dhe për agresorin. Për të pafajshmit dhe ata që nuk kursyen as fëmijët, gratë e pleqtë.

Në Poklek dhe Çikatovë të Vjetër, sot gjithçka ndjehet sikur të kishte ndodhur dije: frika, lutjet dhe kërситmat e zeza të armëve që shuan jetën e dhjetëra civilëve të pafajshëm”, ka shkruar Çitaku në “Facebook”. Edhe kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj ka përkujtuar masakrën e Poklekut dhe Çikatovës së Vjetër, duke theksuar se këto krime janë ndër dëshmitë më të rënda të barbarisë së ushtruar nga shteti serb mbi popullin tonë gjatë luftës. “Edhe pas më shumë se dy dekadash, askush nga urdhërdhënësit dhe ekzekutorët e këtyre krimeve nuk u ndëshkuan nga drejtësia! Lavdi e përjetshme të rënëve për liri!”, ka shkruar Haradinaj në “Facebook”.

## Fillon inspektimi i jashtëzakonshëm në sektorët me rrezikshmëri të lartë

Prishtinë, 17 prill- Inspektorati Qendror i Punës, në zbatim të vendimit të ministrit të Ministrisë për Punë, Familje dhe Vlerat e Luftës Çlirimtare, Andin Hoti, dhe në përputhje me mandatin e tij ligjor, ka filluar aksionin e jashtëzakonshëm të inspektimeve në sektorët me rrezikshmëri të lartë, me fokus të veçantë në sektorin e ndërtimit, në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës.

Ky aksion përfshin të gjitha

rajonet e Kosovës dhe synon rritjen e nivelit të sigurisë dhe shëndetit në punë, si dhe parandalimin e aksidenteve dhe incidenteve në vendin e punës. Në kuadër të këtij aksioni, Inspektorati Qendror i Punës ka angazhuar mbi 90% të kapaciteteve të tij njerëzore, duke formuar 15 grupe inspektimi, të cilat do të zhvillojnë kontrole intensive në terren në të gjitha rajonet e vendit.

Aksioni do të zhvillohet në dy

ndërrime të punës dhe do të zgjasë për një periudhë prej 15 ditësh.

Inspektorati Qendror i Punës mbetet i përkushtuar në përmbushjen e mandatit të tij ligjor dhe njofton opinionin publik dhe subjektet ekonomike se aktivitetet inspektuese do të vazhdojnë edhe pas përfundimit të këtij aksioni, me qëllim të garantimit të një mjedisi të sigurt dhe të shëndetshëm pune për të gjithë punëtorët.



## MINTI gjobit KEDS-in me 30 mijë euro për njehsorë me afat të skaduar

PRISHTINË, 17 PRILL - Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit (MINTI) ka shqiptuar gjobë në vlerë prej 30 mijë eurosh ndaj KEDS, pasi janë konstatuar gjashtë njehsorë elektrikë me afat të skaduar të verifikimit.

Sipas njoftimit zyrtar, ky veprim është ndërmarrë në kuadër të aktiviteteve të

vazhdueshme të kontrollit të njehsorëve elektrikë në të gjithë territorin e Kosovës.

Komisioni Verifikues është duke zhvilluar inspektime në shtatë rajonet e vendit, me qëllim identifikimin dhe adresimin e parregullsive eventuale.

Rezultatet e deritanishme nga analizat laboratorike të kryera në Agjencia e Metrologjisë së

Kosovës kanë treguar pasaktësi në regjistrimin e orës dhe datës në njehsorët e testuar.

Në këtë drejtim, MINTI ka bërë me dije se i ka dorëzuar kërkesë zyrtare KESCO për kompensimin e konsumatorëve të dëmtuar, ndërsa do të vazhdojë të monitorojë procesin përmes raporteve të rregullta.

Po ashtu, Komisioni

Verifikues është në bashkëpunim të ngushtë me Prokurorinë dhe organet e hetuesisë për trajtimin e mëtejshëm të rastit.

MINTI ka theksuar se mbetet e përkushtuar për transparencë dhe informim të vazhdueshëm të qytetarëve, në funksion të mbrojtjes së konsumatorëve dhe adresimit të ankesave të tyre.



## GUVERNATORI I BQK-së TAKON ZËVENDËSDREJTORIN MENAXHUES TË FMN-SË, VLERËSOHET MBËSHTETJA NGA KY INSTITUCION

PRISHTINË, 17 PRILL - Në kuadër të pjesëmarrjes në Takimet Pranverore 2026 të Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) dhe Bankës Botërore (BB), që po mbahen në Uashington, guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), Ahmet Ismaili, ka zhvilluar një takim bilateral me zëvendësdrejtorin menaxhues të FMN-së, Bo Li. Gjatë takimit, guvernatori Ismaili prezantoi zhvillimet më të fundit në ekonominë e Kosovës, duke përfshirë performancën e sektorit financiar, progresin në ruajtjen e stabilitetit financiar dhe avancimin e reformave strukturore. Ai paraqiti

gjithashtu zhvillimet financiare dhe monetare në vend, me theks të veçantë në indikatorët kryesorë që dëshmojnë qëndrueshmërinë e sistemit financiar.

Në këtë kuadër takimit të përbashkët me pjesëmarrjen e ministrit Murati, të mbajtur në formatin e FMN-së, guvernatori Ismaili e njoftoi Lin mbi zhvillimet financiare në vend, ndërsa theksoi forcimin e kornizës rregullative, reformat e ndërmarra dhe stabilitetit financiar. Ai gjithashtu nënvizoi mbështetjen e BQK-së për iniciativat rajonale, përfshirë iniciativën e FMN-së për



Qendrën Rajonale të Asistencës Teknike (SEETAC), me synim ngritjen e kapaciteteve institucionale. Po ashtu, ai vuri në pah progresin në reformat për fuqizimin e integritetit të

sistemit financiar me kontributin e asistencave teknike të FMN-së.

Guvernatori Ismaili vlerësoi mbështetjen e vazhdueshme të FMN-së në forcimin e

kapaciteteve institucionale të BQK-së dhe në zbatimin me sukses të rekomandimeve nga misionet e saj, përfshirë atë të Artikullit IV.

Nga ana e tij, Li vlerësoi progresin e arritur nga ana e BQK, duke theksuar rëndësinë e vazhdimin të reformave dhe bashkëpunimit të ngushtë ndërinstitucional, me mundësinë e zgjerimit me programe të reja. Ky takim konfirmoi përkushtimin e ndërsjellë për thellimin e partneritetit institucional ndërmjet BQK-së dhe FMN-së, në funksion të përmbushjes së objektivave zhvillimore.

## SHAHINI: VONESAT POLITIKE PO RREZIKOJNË PËRFITIMET E KOSOVËS NGA PLANI I RITJES SË BE-së

PRISHTINË, 17 PRILL - Kryetari i Aleancës Kosovare të Bizneseve, Agim Shahini, ka kritikuar institucionet e Republikës së Kosovës në lidhje me vonesat në përmbushjen e obligimeve që lidhen me Planin e Rritjes së Bashkimit Evropian.

Shahini në një intervistë për "Ekonomia Online" ka thënë se Kosova po përballet me humbje të kohës dhe të përfitimeve financiare nga ky plan, i cili kap vlerën mbi 882 milionë euro.

Ai ka theksuar se deri më tani vendi ka arritur të përfitojë rreth 61 milionë euro, që përbën vetëm rreth 7% të shumës së premtuar. "Aleanca Kosovare e Bizneseve ka qenë gjatë gjithë kohës kritikuese e institucioneve të Republikës së Kosovës për humbje të kohës dhe të përfitimit nga plani i rritjes ku janë mbi 882 milionë euro, dhe kur tashmë është bërë e ditur se rreth 61 milionë euro ne do t'i



kemi në dispozicion, është vetëm 7% nga shumata e premtuar për Kosovën. E vendi ynë është zotuar që do t'i plotësojë mbi 111 kriteret ose hapa të cilët duhet të merren. Po ashtu, Kosova për t'i plotësuar të gjitha këto duhet në fazën e vazhdimësisë. Deri në qershor duhet t'i plotësojë më

së paku edhe një 13 kriteret, e që është afati shumë i shkurtër dhe besoj se Kosova do t'i arrijë këto. Nëse jo, atëherë kriza politike do të bartet në krizën ekonomike dhe faktori i politikës. Po ashtu, pritet që deri në fund të vitit institucionet e Kosovës t'i bëjnë edhe 27 kriteret të tjera t'i plotësojnë për të arritur si përfitues i barabartë me rajonet e tjera, sepse Shqipëria dhe Serbia kanë marrë përafërsisht mbi 180 milionë euro deri tash, kurse Kosova tash ka filluar, për shkak të ngërçeve politike, për shkak të paqartësive politike dhe zbehjes së raporteve me faktorin ndërkombëtar", ka thënë Shahini.

Ai ka thënë se nëse Kosova vazhdon të humbë edhe më tutje, përgjegjësia duhet të kërkohet në Prishtinë e jo në Bruksel. "Sado një hap i vogël që ka marrë Qeveria e Kosovës dhe

këto marrëveshje që janë ratifikuar në Kuvendin e Kosovës, mungesa e tyre neve na ka zgjatur. Tash e dy vjet kemi qenë në sanksione dhe nuk kemi përfituar asgjë. Prandaj nëse ne do të humbim edhe më tutje, atëherë ne duhet ta kërkojmë përgjegjësinë në Prishtinë dhe jo në Bruksel", ka thënë ai.

Pas ratifikimit në Kuvend të marrëveshjeve të lidhura me Planin e BE-së për Rritje Ekonomike dhe dorëzimit të dokumentacionit të nevojshëm nga Qeveria, të enjten Komisioni Evropian ka nisur bartjen e mjeteve të parafinancimit prej 61.8 milionë eurosh për Kosovën përmes Instrumentit për Reforma dhe Rritje sipas Planit të BE-së për Rritje Ekonomike për Ballkanin Perëndimor, duke i dhënë kështu një stimul të rëndësishëm avancimit të reformave.

Siç njofton Zyra e BE-së në Kosovë, parafinancimi përfaqëson 7% të totalit prej 882.6 milionë eurosh grante dhe kredi të favorshme në dispozicion të Kosovës në kuadër të Planit për Rritje Ekonomike deri në fund të vitit 2027.

Këto mjete, sipas njoftimit, do të përkrahin zbatimin e Agjendës së Reformave të Kosovës dhe projekte kyçe në infrastrukturë të mbështetura nga Korniza e Investimeve të Ballkanit Perëndimor (WBIF), duke e afuar edhe më shumë Kosovën me BE-në. "Prej 61.8 milionë eurove, sot në buxhetin e Kosovës janë bartur 28.74 milionë euro kredi, ndërsa shumata e mbetur - 33.04 milionë euro (17.73 milionë grante dhe 15.31 milionë kredi) - do të kanalizohet përmes WBIF-it", ka theksuar Nikola Gaon, zëdhënës i BE-së në Kosovë të enjten.

## AKP-ja ofron për qira 604 pronat në rajone të ndryshme të Kosovës

PRISHTINË, 17 PRILL - Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) ka shpallur ofertën publike për qiradhënien e gjithsej 604 pronave, të shpërndara në disa rajone të Kosovës, duke ofruar mundësi të reja për zhvillim ekonomik dhe investime.

Asetet e ofruara përfshijnë lokale afariste, parcela tokësore,

depo dhe zyra, të cilat janë të përshtatshme për aktivitete të ndryshme biznesore. Qiradhënia realizohet në forma vjetore, mujore dhe komerciale, në varësi të natyrës së pronës.

Sipas shpërndarjes rajonale, numri më i madh i pronave ndodhet në rajonin e Pejës, me gjithsej 433 njësi në

dispozicion. Ndërkohë, në rajonin e Mitrovicës janë ofruar 40 pronat, ndërsa në rajonin e Gjilanit janë në dispozicion 131 pronat.


AKP-ja u bën thirrje të gjitha subjekteve të interesuara që të aplikojnë brenda afatit të përcaktuar. Afati i fundit për dorëzimin e ofertave është 28

prill 2026, ndërsa ofertat duhet të dorëzohen në zarf të mbyllur në zyrat rajonale përkatëse të AKP-së, nga ora 10:00 deri në 12:00. Hapja e ofertave do të bëhet në të njëjtën ditë, duke filluar nga ora 12:30.

Të gjitha informatat e detajuara lidhur me asetet e ofruara mund të merren në zyrat



rajonale respektive të AKP-së: Pejë, Mitrovicë dhe Gjilan, si dhe në faqen zyrtare të AKP-së.



## Armand Duka hap derën për vazhdimin e kontratës së Sylvinhos

PRISHTINË, 17 PRILL - Presidenti i Federatës Shqiptare të Futbollit, Armand Duka, ka lënë të kuptohet se e ardhmja e trajnerit të Kombëtares, Sylvinho, mund të lidhet edhe më gjatë me kuqezinjtë. Në

një deklaratë të fundit, Duka ka konfirmuar se federata është e gatshme t'i ofrojë një kontratë të re teknikut brazilian, duke vlerësuar punën e tij në krye të përfaqësueses. "Ne do t'i

ofrojmë kontratë të re. I duhet kohë për të menduar", është shprehur ai, duke lënë gjithçka të hapur për vazhdimësinë e bashkëpunimit. Që prej marrjes së drejtimit të

Kombëtares së Shqipërisë, Sylvinho ka sjellë një frymë të re në ekip, duke rritur besimin dhe rezultatet, çka ka shtuar dëshirën e drejtuesve për ta mbajtur atë në krye të skuadrës edhe në të ardhmen.



## DRITON KUKA PAS PËRFUNDIMIT TË KAMPIONATIT EVROPIAN: NJË MEDALJE E ARTË DHE PARAQITJE PREMTUESE PËR KOSOVËN



TBILISI, 17 PRILL - Trajneri i ekipit të Kosovës në xhudo, Driton Kuka la vlerësuar performancën e ekipit në Tbilisi të Gjeorgjisë dhe ka theksuar vazhdimësinë e suksesit të xhudës. Kosova ka përfunduar garat në Kampionatin Evropian për të rritur në Tbilisi, me një tjetër sukses të madh që mban vulën e xhudës.

Sipas trajnerit Driton Kuka, Distria Krasniqi, ka shkëlqyer duke siguruar medaljen e artë të 11-të evropiane për vendin, duke vazhduar një traditë 14-vjeçare suksesi me mbi 30 medalje në total. Paraqitje shumë të mirë ka pasur edhe Akili, i cili ka regjistruar tri fitore dhe një humbje, duke luftuar për medalje dhe duke u renditur në vendin e pestë.

Ndërkohë, Dardani dhe Fatjona kanë arritur deri në mesin e 16 më të mirëve, ndërsa Erza dhe Laura janë eliminuar herët, pavarësisht përgatitjeve të mira. "Për njerëz që ta kuptojnë drejt medalje të arta Evropiane në sporte olimpikë deri tash sporti i shtetit tonë i ka 11 dhe të gjitha nga xhudo! Do dikush me i pa apo jo, ky është realiteti", ka thënë Kuka.

## FISNIK ASLLANI PO SHKËLQEN NË BUNDESLIGË: PO JETOJ ËNDRRËN E BABAIT TIM

HOFFENHEIM, 17 PRILL - Sulmuesi i Hoffenheimit dhe Kombëtares së Kosovës, Fisnik Asllani është kthyer në një nga emrat më të lakuar në Bundesligën gjermane këtë sezon, duke kontribuar në formën e mirë të skuadrës me gola dhe asistime në vitin e tij të parë si titullar. Në një intervistë të dhënë për faqen zyrtare të Bundesligës, 23-vjeçari ka treguar sekretet e formës së tij të lartë dhe krenarinë që ndjen duke përfaqësuar Kosovën.

Asllani është shprehur se suksesi i tij vjen si pasojë e punës që nuk e ka ndalë kurrë, edhe kur gjërat nuk dukeshin premtuese gjatë huazimeve te Austria Vienna dhe Elversberg. "Përpiqem ta shijoj futbollin dhe të argëtohem. Kur jam i lumtur, luaj futbollin tim më të mirë", ka thënë Asllani, duke shtuar se e sheh profesionin e tij si një hobi që është bërë punë. Për Asllanin, qëndrimi me këmbë në tokë vjen nga edukimi familjar dhe

sakrificat e prindërve të tij që kishin ikur nga lufta. "Në një farë mënyre po jetoj ëndrrën e babait tim. Ai dëshironte të bëhej futbollist profesionist, por nuk i pati mundësitë", ka thënë ai. Sa i përket përfaqësueses, Asllani ka qenë protagonist kryesor për Kosovën, duke shënuar gola vendimtarë në kualifikimet për Botëror dhe në gjysmëfinalen e "play-off"-it kundër Sllovakisë. Ai deri më tani ka shënuar katër gola në 14



paraqitjet e para me "Dardanët". Ndonëse Hoffenheimi po kalon një moment rënieje pas një fillimi fantastik, ekipi mbetet në top-gjashtëshen e tabelës. Asllani e sheh përballjen e radhës kundër Dortmundit (vendi i dytë) si një mundësi të shkëlqyer për t'u rikthyer te rezultatet pozitive. "Dortmundi është i dyti për një arsyë, por ne do të fokusohemi te vetja dhe do të japim gjithçka", ka thënë Asllani.

## E KONFIRMON YAKIN: XHAKA DO TË VAZHDOJË ME ZVICRËN EDHE PAS BOTËRORIT



BERN, 17 PRILL - Granit Xhaka pritet të mbetet pjesë kyçe e Zvicrës edhe në vitet e ardhshme, duke hedhur poshtë spekulimet për tërheqje. Mesfushori 32-vjeçar vazhdon të jetë lider i

padiskutueshëm në ekip. Trajneri Murat Yakin ka përjashtuar mundësinë që Kupa e Botës të jetë fundi i tij, duke theksuar se Xhaka do të luajë sa të jetë në formë dhe i shëndetshëm. Sipas tij,

kapiteni do të vazhdojë edhe pas këtij turneu. Marrëdhënia mes tyre është përmirësuar pas tensioneve të mëhershme, ndërsa kontrata e Yakinit deri në Euro 2028 tregon për një projekt

afatgjatë ku Xhaka mbetet figurë kyçe. Me 144 paraqitje, ai është rekordmeni i Zvicrës dhe vazhdon të jetë vendimtar në mesfushë, duke garantuar stabilitet për ekipin.


## Murali i Messit në Tiranë bëhet viral nëpër botë

Tiranë, 17 shkurt - Një mural i ri i Lionel Messit është zbuluar së fundmi në Tiranë, Shqipëri, duke tërhequr vëmendjen e tifozëve të futbollit dhe jo vetëm. Imazhi i yllit argjentinas është pikturuar në një mur urban, duke e kthyer zonën në një pikë

interesante për fotografi dhe vizita. Fotografia është shpërndarë nga gazetari i njohur, Fabrizioo Romano, i cili ka publikuar në rrjetet sociale, duke e bërë menjëherë virale mes ndjekësve të tij anembanë botës. Postimi i tij ka nxitur reagime të shumta pozitive, me

shumë fansa që vlerësojnë këtë formë arti dhe dedikimi ndaj një prej futbollistëve më të mëdhenj të të gjitha kohërave. Murali i Messit në Shqipëri shihet si një tjetër dëshmi e ndikimit global që ai ka në kulturën sportive dhe më gjerë. Interesi i publikut është rritur

ndjeshëm, duke e kthyer këtë mural në një simbol të pasionit për futbollin në rajon. Ky zhvillim vjen në një kohë kur Messi vazhdon të mbetet një figurë ikonike, duke frymëzuar miliona tifozë në mbarë botën dhe tani edhe në rrugët e Shqipërisë.









## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gasosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



**MEKA**  
HALAL FOOD

# TRADITË QË NGA

# 1992

